



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Data: 12.05.2023

Nr: 102

Ora: 13:05

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 25, DATË 10.05.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË  
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 12.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

**OBJEKT:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Gledian Llatja, kryetar i bashkisë Elbasan; ndaj z. Andis Salla, kryetar i bashkisë Cërrik; ndaj z. Rakip Suli, kryetar i bashkisë Kamëz.

**BAZË LIGJORE:**

Neni 19, pika 1, shkronja "c" dhe neni 21, pika 1, shkronja "dh" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

**Rrethanat e çështjes:**

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë denoncime për organizimin e veprimtarive publike nga tre institucione publike, konkretisht për bashkitë Elbasan, Cërrik, dhe Kamëz, për të cilat pretendohet se janë shkelur parashikimet e nenit 91 dhe nenit 92 të Kodit Zgjedhor.
2. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ, në përfundim të të cilit, ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të një kërkesë, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë ndaj kryetarëve të bashkisë Elbasan, bashkisë Cërrik, si dhe bashkisë Kamëz në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
3. KAS-i caktoi me short z. Ledio Braho relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 25, datë 10.05.2023 të Komisionerit dhe në seancën paraprake vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më 12.05.2023, ora 13:05.
4. Seanca e datës 12.05.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Kryetarët e bashkive ose përfaqësues të tyre, të njoftuar rregullisht, nuk u paraqitën në seancën e shqyrtimit.
5. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
  - Kërkesën nr. 25, datë 10.05.2023 të Komisionerit;
  - Vendimin e Komisionerit nr. 470 datë 09.05.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve";
  - Denoncimin nr. 219 ID për bashkinë Elbasan;
  - Denoncimet nr. 172, dhe nr. 173 ID për bashkinë Cërrik;

- Denoncimet nr. 182 dhe nr. 183 ID për bashkinë Kamëz;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

#### **KAS-i konstaton:**

1. Denoncimet me nr. 219 ID ndaj Bashkisë Elbasan, denoncimet me nr. 172 dhe nr. 173 ID ndaj bashkisë Cërrik, si dhe denoncimet me nr. 182 dhe nr. 183 ID ndaj bashkisë Kamëz, i referohen veprimtarive të zhvilluara gjatë muajit mars 2023. Komisioneri, pas hetimit administrativ të këtyre denoncimeve ka konstatuar se *“përdorimi i aktiviteteve të organizuara nga institucione publike për të kryer thirrje elektorale në mbështetje të një force politike apo kandidati të caktuar, përbën shkelje të detyrimeve të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Kryetarët e bashkive të sipërcituara, nëpërmjet vënies në dispozicion të këtyre aktiviteteve për kryerjen e thirrjeve elektorale, kanë shkelur parashikimet e këtij neni”*.
2. KAS është shprehur në vendime të mëparshme lidhur me këtë lloj shkeljeje të pretenduar dhe ka rrëzuar kërkesat e Komisionerit me arsyetimin si vijon.
3. Pika 1 e nenit 91 nuk lejon që kryetari i bashkisë të përdorë ose të vërë në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve NË ZGJEDHJE burime të institucionit që drejton, si në formën e aseteve, ashtu dhe në formën e burimeve njerëzore. Asetet i ka përcaktuar neni 142 i Kodit Civil. Ato janë sende të luajtshme apo të paluajtshme. Veprimtaria në vetvete nuk është send, nuk formon aset, nuk mund të jetë burim, për pasojë nuk mund të bëjë pjesë në objektin e dispozitës së nenit 91, pika 1. Gjatë veprimtarisë mund të përdoren sende, të cilat formojnë asete dhe që janë burime. Por këto sende duhet të identifikohen, të saktësohet pronësia apo të drejtat reale të bashkisë mbi to, përpara se veprimtaria të konsiderohet veprimtari e ndaluar dhe kryetari i bashkisë të merret në përgjegjësi administrative.
4. Lista e veprimtarive të ndaluara, sipas pikës 1 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, është listë e numërtuar (nga “a” tek “dh” e nën pikës 1.3), sikurse është e

numërtuar lista e veprimtarive të ndaluara për t'u promovuar (nga "a" tek "d" e nën-pikës 1.1). Kjo do të thotë se llojet e veprimtarive të ndaluara dhe të veprimtarive të ndaluara për t'u promovuar janë të përcaktuara në mënyrë strikte. Atyre nuk mund t'u shtohen lloje të reja veprimtarie, nuk mund të pasurohen as nga Komisioneri, as nga KAS-i. Lista mund të pasurohet vetëm në rrugën e amendimit të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020. "Përdorimi i aktivitetit të organizuar nga një organ publik" nuk bën pjesë në listën e veprimtarive sipas nën-pikës 1.3 të pikës 1 të nenit 3, nuk formon dot "veprimtari të ndaluar".

5. Veprimtaritë e denoncuara janë veprimtari me karakter të qartë politik/elektoral. Ato janë zhvilluar në kuadër të veprimtarive politiko-elektorale të Partisë Socialiste, gjegjësisht në dobi të saj. Ndryshe nuk ka shpjegim, as justifikim, pjesëmarrja në veprimtari e drejtuesit politik të Qarkut. Pjesëmarrja e kryetarëve të Bashkisë Elbasan, Cërrik dhe Kamëz, gjithashtu, mund të vlerësohet në këtë kontekst, sa kohë që kryetari i bashkisë ka qenë në momentin e zhvillimit të veprimtarisë kandidat i subjektit "Partia Socialiste" për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Veprimtaritë në dobi të subjektit politik nga ana e këtyre zyrtarëve shtetërorë nuk janë, në vetvete, të kundërligjshme. Vetëm koha kur kryhen ato mund të shkaktojë përplasje me ligjin.
6. Pika 1 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor përcakton se "...nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve NË ZGJEDHJE burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia". Kjo dispozitë është përsëritur në mënyrë të ngjashme edhe nga vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 në përkufizimin e "veprimtarive të ndaluara" kur ndalon "vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme ... për QËLLIME ZGJEDHORE".
7. Kodi ka përcaktuar periudhën e fushatës zgjedhore, si një periudhë që zgjat nga 30 ditë para datës së zgjedhjeve, deri 24 orë para datës së zgjedhjeve (neni 77), ka përcaktuar periudhën kur nuk lejohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve të caktuara ligjore ose nënligjore, e cila është katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve (pika 4 e nenit 91), por nuk ka përcaktuar periudhën kur vepron ndalimi sipas pikës

1 të nenit 91, kur fillojnë “ZGJEDHJET” dhe as kur mbarojnë ato. Nga ana tjetër nuk ka asnjë akt me karakter normativ nga ana e KQZ-së që të përcaktojë momentin kur fillon të veprojë ndalimi i përdorimit të burimeve të organeve apo enteve publike që kërkon ky nen. Vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 nuk e ka saktësuar këtë përkufizim. Në nënpikën 1.3, të pikës 1 të nenit 3 të tij, teksa jep përkufizimin e “veprimtarive të ndaluara”, vendimi vendos afatin për të cilin vepron ndalimi për secilën nga kategoritë e veprimtarive të ndaluara, me përjashtim të veprimtarive të përkufizuara nga shkronja “c” dhe nga shkronja “dh” e tij, për të cilat nuk ka afat.

8. Në kushtet e mungesës së një përcaktimi detyrues që do t’ a vendoste fillimin e veprimit të afatit të ndalimit në një datë më të hershme, subjektet zgjedhore dhe institucionet janë të lira ta çojnë afatin në limitin e tij ligjor, që është data e fillimit të fushatës zgjedhore, d.m.th. 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Kjo nuk do të formonte shkelje të ligjit, sepse “PERIUDHA E FUSHATËS ZGJEDHORE”, sikurse është përcaktuar nga Kodi Zgjedhor e mbulon konceptin “ZGJEDHJE” të pikës 1, të nenit 91.
9. KAS-i mund të marrë masa administrative ndaj subjekteve ose përfaqësuesve të institucioneve vetëm nëse konstaton shkeljen e dispozitave të caktuara detyruese ligjore, por nuk mund të sanksionojë administrativisht për veprime, të cilat nuk është ligjërish e qartë nëse janë kryer brenda apo jashtë periudhës së ndalimit. Kuadri ligjor i paqartë nuk mund të zbatohet në dëm të subjekteve. Ndëshkim pa shkelje dhe pa faj nuk mund të ketë.
10. Bazuar në këtë analizë të fakteve dhe të kuadrit ligjor, KAS nuk e gjet të mbështetur kërkesën për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj kryetarëve të bashkisë Elbasan, Cërrik dhe Kamëz, dhe as procedimin e subjektit zgjedhor përfitues. Në mungesë të përcaktimit ligjor të afatit kur vepron ndalimi sipas pikës 1 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, është e pamundur që veprimtaria e denoncuar të cilësohet “veprimtari të ndaluar”, përveçse pasi të ketë filluar “periudha e fushatës zgjedhore”.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja 'dh', të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me shumicë votash,

## V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksioneve administrative.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

**Ledio      BRAHO      -      Relator      (Kundër)**

**Elvin      LAKO      -      Anëtar**

**Elvis      ÇEFA      -      Anëtar      (Kundër)**

**Ilirjan      RUSMALI      -      Anëtar**

**Koli      BELE      -      Anëtar**

## MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesës nr. 25, datë 10.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ”, ne, anëtarët në pakicë, duke mos qenë dakord me konkluzionet dhe argumentet e parashtruara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi të mendimit se KAS duhet të pranonte kërkesën e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj:

- z. Gledian Llatja, Kryetar në Bashkinë Elbasan;
- z. Andis Salla, Kryetar në Bashkinë Cërrik; dhe
- z. Rakip Suli, Kryetar në Bashkinë Kamëz.

2. Në lidhje me të tre rastet shumica e anëtarëve të KAS e pranon faktin e përdorimit të burimeve publike në çështjen objekt shqyrtimi, por argumenton se është në pamundësi ligjore për ta konsideruar aktivitetin objekt shqyrtimi si në shkelje të nenit 91 të K.Zgjedhor përderisa sipas tyre si ligjvënësi ashtu dhe Komisioni Rregullator nuk kanë përcaktuar një afat (30 ditor që lidhet me fushatën zgjedhore apo 4 muaj para ditës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve) se kur fillon ndalimi i përdorimit të burimeve publike në favor të kandidatëve, partive politike ose koalicioneve në zgjedhje. Shumica e anëtarëve të KAS e trajton institutin e ndalimit të përdorimit të burimeve publike si në kushtet e “ometimit ligjor”. Ometimi ligjor është koncept tashmë i afirmuar në doktrinën juridike, praktikën gjyqësore dhe, në veçanti, atë kushtetuese. Ometimi është identifikuar, si në rastet kur norma juridike nuk ka rregulluar një marrëdhënie të caktuar, që në të vërtetë duhej të rregullohej (*ometimi absolut*), ashtu edhe kur norma nuk ka arritur të përmbushë në mënyrën e plotë dhe të duhur këtë detyrim (*ometimi relativ*).

3. Për ne anëtarët në pakicë, neni 91 pika 1 e K.Zgjedhor, në lidhje me mospërdorimin e burimeve publike nuk është në kushtet e konceptit të “ometimit relativ” për shkak të afatit, pasi kjo dispozitë duhet interpretuar së bashku me pikat e tjera të nenit 91 si dhe me nenin 92 të K.Zgjedhor. Më konkretisht, neni 91 pika 1 e K.Zgjedhor përcakton parimin e mospërdorimit të burimeve publike në zgjedhje (pa përcaktuar termin fushatë zgjedhore që detyrimisht të referon te afati 30 ditë nga dita e zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve), më tej pika 2 e nenit 91, në fjalinë e parë jep kuptimin e “burimit” duke përkufizuar llojet e burimeve në asete të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe në

burime njerëzore, ndërkohë në fjalinë e dytë parashikon mospërdorimin e burimeve njerëzore (duke e përcaktuar në mënyrë eksplicite vetëm për burimet njerëzore) në fushatë zgjedhore, në këtë mënyrë vendoset dhe afati i ndalimit të burimeve njerëzore. Në pikën 3 të po të njëjtit nen, trajtohet sërish koncepti i burimeve njerëzore, por tashmë në kuptim të marrjes në punë, pushimit nga puna etj. dhe afati edhe në këtë rast lidhet me periudhën e fushatës zgjedhore. Më tej, në pikën 4 të po të njëjtit nen trajtohet një veprimtari tjetër që ka të bëjë me iniciativat ligjore apo nënligjore dhe këtu afatin e ndalimit ligjvënësi e përcakton në harkun kohor 4 muaj para ditës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë. Neni 92 i K.Zgjedhor, në pikën 1 të tij parashikon se *“1. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*. Më tej, në pikat 2 deri 6 të këtij neni, detajohet mënyra e raportimit, rastet kur ndalohen aktivitetet nga KQZ etj..

4. Nga arsyetimi më sipër, del qartë që për aq kohë sa raportimi i aktiviteteve publike duhet të kryhet gjatë gjithë periudhës 4 muaj para ditës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, atëherë edhe ndalimi i përdorimit të burimeve publike vlen për të njëjtën periudhë. Nëse arsyetojmë *a contrario*, që nëse ndalimi i përdorimit të burimeve publike do të vlente vetëm periudhën zgjedhore, atëherë përse duhet të raportoheshin aktivitetet edhe për periudhën e hershme 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve?! Një interpretim i tillë e bën dispozitën alogjike dhe e shndërron në fiktive. Ndaj, për ne anëtarët në pakicë të KAS, neni 91 pika 1 nuk është në kushtet e konceptit të *“ometimit relativ”* sa i përket afatit të zbatimit të dispozitës, por është një dispozitë me karakter detyrues për periudhën 4 muaj para ditës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

5. Në rastin e bashkive Kamëz dhe Elbasan kandidatët për kryetarë bashkie në bashkitë Kamëz dhe Elbasan gëzojnë status të dyfishtë, si kandidatë dhe si Kryetarë në detyrë të bashkive respektive. Si kryetarë të bashkive, ata kanë akses, dijeni dhe përgjegjësi për postimet në faqet zyrtare të bashkive që ata drejtojnë. Ata kanë gjithë pushtetin e nevojshëm ligjor për të urdhëruar ndërprerjen e shkeljes së ligjit dhe për të marrë masa që këto sjellje të mos përsëriten. Fakti që ata nuk e kanë ushtruar këtë pushtet deri ditën e urdhërimit nga Komisioneri do të thotë se ata duhet t'i



nënshtrohen, si subjekt zgjedhor, veprimit të sanksionit të parashikuar nga pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor. Për procedimin apo caktimin e masës së sanksionit, KAS-i duhet të çmonte dhe t'i jepte peshën që i takon faktit se ende nuk ka perceptim të qartë ndër aktorët se përdorimi i adresës zyrtare të institucionit në *Facebook* për fushatë elektorale përbën keqpërdorim të burimeve publike.

6. Në lidhje me kryetarin e Bashkisë Cërrik, nga Bashkia që ai drejton është raportuar aktiviteti me titull *"Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike Shalës"*. Nga fjala e drejtuesit politik të PS qarku Elbasan, rezulton ndër të tjera se ai është shprehur *"(...) Mirë mirë po ja dhe ky do mbështetje. Ky bën punë, ju e mbështesni më shumë, do bëjë edhe më shumë punë. Kështu funksion. (...) Ama, ne duhet të falenderojmë këtë si kryetar bashkie për punët që ka bërë, dhe ju jap llafin që ky ka punuar shumë mirë, me mbështetjen tuaj do marrë edhe mbështetjen tonë të madhe, edhe të kryeministrit Rama me projekte të tjera."*

7. Siç rezulton nga përmbajtja e fjalimit në aktivitetin e sipërcituar që është organizuar nga Bashkia Cërrik, është mbajtur fjalim me përmbajtje politike dhe elektorale nga përfaqësuesi politik i PS në Elbasan.

Komisioni Rregullator pranë KQZ, në zbatim të detyrimeve të parashikuara nga nenet 90 dhe 92 të K.Zgjedhor, ka nxjerrë vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve". Në nenin 1 të këtij vendimi që përcakton qëllimin dhe objektin e tij, Komisioni Rregullator, ka përcaktuar se ky akt normativ është nxjerrë **"... me synim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake"**. Në nenin 7 shkronjat "dh" dhe "e" të këtij vendimi ku parashikohen detyrat e sekretarëve të përgjithshëm të institucioneve publike, të pavarura e të varësisë, ndër të tjera parashikohet se **"1. Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë: ... dh) marrin masa për ndalimin e iniciativave elektorale ndikuese, diktuese dhe urdhëruese apo të propagandës politike,**

*në funksion të fushatës zgjedhore, në institucionet publike përkatëse; e) marrin masa dhe realizojnë monitorimin e zbatimit të tyre, për të penguar keqpërdorimin dhe garantuar mospërdorimin e: ... v) veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore”.*

Për ne anëtarët në pakicë, është e qartë që shfrytëzimi i aktivitetit të organizuar nga Bashkia Cërrik për përcjelljen e mesazheve elektorale, çënon sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike dhe krijon kushte të pabarabarta (disfavorizuese) për kandidatët e tjerë apo për partitë e tjera politike që marrin pjesë në zgjedhje. Nëse një sjellje e tillë e një kryetari bashkie nuk do të konsiderohej në kundërshtim me qëllimin dhe objektin e vendimit të sipërcituar të Komisionit Rregullator, atëherë duhet të pranojmë se kemi të bëjmë me një akt normativ të pazbatueshëm. Po në të njëjtin përfundim do të dilej edhe në lidhje me nenin 91 të K.Zgjedhor nëse do të pranohet që aktivitete si ato të organizuara nga Bashkia Cërrik nuk çënojnë sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike. Është alogjike të mendosh se një aktivitet i organizuar nga Bashkia Cërrik, mund të organizohet pa përdorur asnjë burim të saj, në kuptim të burimeve sipas nenit 91 të K.Zgjedhor. Dy janë mundësitë për të organizuar aktivitete të tilla: 1. Aktivitet i organizuar nga Bashkia Cërrik dhe që ka përdorim të burimeve të Bashkisë Elbasan; ose 2. Aktivitet politik i kandidatit për Bashkinë Cërrik me burime që duhet të deklarohen nga partia politike që e mbështet ose vetë kandidati në kuptim të fushatës zgjedhore. Një aktivitet me status të ndryshëm nga këto më sipër, nuk mund të ketë ku organizator të jetë Bashkia Cërrik apo Kryetari i Bashkisë Cërrik.

Ndaj, për sa më sipër, KAS duhet të pranonte kërkesën e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Kryetarit të Bashkisë Cërrik, z. Andis Salla.

**Anëtarë: Elvis Çefa, Ledio Braho**